

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-
AR73.2

Data: 31 maj 2011

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësi Patrick Robinson, Kryegjykatës
Gjykatësi Fausto Pocar
Gjykatëse Liu Daqun
Gjykatësi Andrésia Vaz
Gjykatësi Theodor Meron

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 31 maj 2011

**PROKURORI
kundër
RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI KËRKESËN E IDRIZ BALAJT DHE LAHI BRAHIMAJT PËR
QARTËSIM TË AKTAKUZËS NË FUQI**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Ramush Haradinajt:

Z. Ben Emmerson QC
Z. Rodney Dixon

Z.

Avokatëve të Idriz Balajt:

Z. Gregor Guy-Smith
Zj. Colleen M. Rohan

Avokatëve të Lahi Brahimaajt

Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop

DHOMA E APELIT e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali”);

PASI KA MARRË “Dosje e Apelit në Emër të Idriz Balajt mbi Qartësimin e Aktakuzës në Fuqi” (“Apel”) dhe “Kërkesën e Lahi Brahimajt për Bashkim me Apelin e Dorëzuar nga Idriz Balaj mbi Qartësimin e Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi” (“Kërkesë për Bashkim”), dorëzuar përkatësisht nga Idriz Balaj (“Balaj”) dhe Lahi Brahimaj (“Brahimaj”), më 3 mars 2011.

DUKE MARRË SHËNIM “Përgjigje e Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit në Emër të Balajt mbi Qartësimin e Aktakuzës në Fuqi dhe Kërkesës për Bashkim të Brahimajt”, dorëzuar nga Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”) më 10 mars 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Kundërpërgjigje e Idriz Balajt mbi Qartësimin e Aktakuzës në Fuqi” dhe “Kundërpërgjigje e Lahi Brahimajt për Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit Dorëzuar nga Idriz Balaj, të cilës iu bashkua dhe Brahimaj, mbi Qartësimin e Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi”, të dyja dorëzuar më 17 mars 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Mocion i Prokurorisë për Mosmarrje në Konsideratë dhe Kërkesë për Leje për Dorëzimin e Kundërpërgjigjes Shtesë dhe Kundërpërgjigje Shtesë ndaj Kundërpërgjigjeve të Balajt dhe Brahimajt mbi Qartësimin e Aktakuzës në Fuqi”, dorëzuar më 24 mars 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Kërkesë e Idriz Balajt për Leje për Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Dosjes së tij të Apelit dhe “Kërkesë e Lahi Brahimajt për Pranim të Parashtrimit të Vonuar”, të dyja dorëzuar më 28 mars 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt” të 14 janarit 2001, në të cilin Dhoma Gjyqësore II e Tribunalit (“Dhoma

Gjyqësore”) urdhëroi që “ paragrafi 24 [i Aktakuzës në fuqi gjatë rigjykit] të zëvendësohet me paragrafin 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt”;¹

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimin nga Prokuroria “Aktakuzë e Ndryshuar për Herë të Katërt e Rishikuar”, dorëzuar më 21 janar 2011 (“Aktakuzë e Shkurtuar në Fuqi”);²

DUKE MARRË SHËNIM “Kërkesë e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit të 14 janarit 2011 në Lidhje me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për Urdhër Drejtuar Prokurorisë për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar”, dorëzuar më 26 janar 2011 dhe “Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me ‘Kërkesë e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit në Lidhje me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar dhe për Urdhër Drejtuar Prokurorisë Për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar’”, dorëzuar më 27 janar 2011 (së bashku “Mocione”);³

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit të 14 janarit 2011 në Lidhje me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar”, i 8 shkurtit 2011 (“Vendimi i Apeluar”) në të cilin Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë Mocionet e Balaj dhe Brahimajt ku parashtrohej se paragrafi 24 i Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi përmbante akuza kundër të Akuzuarve⁴ ose riparaqiste akuzat për krime për të cilat ata ishin shpallur të pafajshëm me vendim të formës së prerë;⁵

DUKE MARRË SHËNIM “Vendimin mbi Kërkesën e Idriz Balajt Bazuar në Rregullën 73(B) për të Lejuar Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011”, i 24

¹ Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, para 42, duke iu referuar Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktakuzë e Ndryshuar për Herë të Katërt, 16 tetor 2007.

² Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Aktakuzë e Ndryshuar për Herë të Katërt e Rishikuar 21 janar 2011.

³ Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, “Kërkesë e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për Urdhër Drejtuar Prokurorisë Për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar”, 26 janar 2011; Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me “Kërkesë e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për Urdhër Drejtuar Prokurorisë Për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”, 27 janar 2011.

⁴ Ramush Haradinaj (“Haradinaj”), Balaj dhe Brahimaj këtu përmenden bashkërisht si “Të Akuzuarit”.

⁵ Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit Lidhur me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar, 8 shkurt 2011, f. 2-3.

shkurtit 2011, në të cilin Dhoma Gjyqësore urdhëroi lejimin e apelimit të Vendimit të Apeluar me arsyetimin se “çështja e miratimit ose mosmiratimit të ndryshimit [të paragrafit 24] të kërkuar nga Balaj, do të ndikonte thelbësisht në kryerjen e një procesi të drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e procesit”;⁶

DUKE MARRË PARASYSH se çështja në fjalë në parashtrimet dhe vendimet e lartpërmendura është kuadri i paragrafit 24 të Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi;

DUKE MARRË PARASYSH se kuadri i paragrafit 24 të Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi ishte lënda e “Vendimit” e Dhomës së Apelit ‘mbi Apelimin e Haradinajt në lidhje me Kuadrin e Rigjykimit të Pjesshëm” të 31 majit 2011, në të cilin Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë argumentin se në kontekstin e rigjykimit të pjesshëm, paragrafi 24 i Aktakuzës së Shkurtuar në Fuqi e përballte të Akuzuarin me akuza të tjera nga ato që përfshiheshin në rigjykim dhe se rrjedhimisht nuk kishte shkelje apo shkelje të mundshme të parimeve *non bis in idem* ose *res judicata*;⁷

DUKE KONSTATUAR se ky Vendim i nxjerr të panevojshme çështjen e ngritur dhe mjetin ligjor ndreqës të kërkuar në Apelim dhe në Kërkesën për Bashkim;

GJYKON se në këto rrethana nuk është i nevojshëm një vendim mbi meritat

RRËZON Apelimin dhe Kërkesën për Bashkim

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Patrick Robinson
Kryegjykatës

Sot, më datën 31 maj 2011.
Në Hagë

⁶ Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt Bazuar në Paragrafin (B) të Rregullës 73 të Rregullores, për Leje për Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011, 24 shkurt 2011, para 14.

⁷ Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Apelimin e Haradinajt në lidhje me Kuadrin e Rigjykimit të Pjesshëm, 31 maj 2011 (“Vendim”), para 32.

Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]